

VENDIM
Nr.30, datë 11.5.2007

PËR DISA SHITESA NË RREGULLOREN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT

Në mbështetje të nenit 9 pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 21 të “Rregullave të procedurave të licencimit”, miratuar me vendimin nr.21, datë 4.4.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 11.5.2007, pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për një shtesë në rregullat e procedurave të licencimit,

VENDOSI:

1. Në rregulloren e procedurave të licencimit, miratuar me vendimin nr.21, datë 4.4.2007 të Bordit të Komisionerëve, të shtohet në nenin 10 pika 2 paragrafi me përmbajtjen si më poshtë:

“- Në rastet kur personat aplikojnë për licencim në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike, si dhe prodhimit të energjisë elektrike pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave “Për fillimin e procedurave për dhënien me koncesion të objektit...”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, pasi shqyrton rregullsinë e dokumenteve të tjera sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, vendos fillimin e procedurave të licencimit.”.

2. Në rregulloren e procedurave të licencimit, miratuar me vendimin nr.21, datë 4.4.2007 të Bordit të Komisionerëve, të shtohet në nenin 14 pika 2 paragrafi me përmbajtjen si më poshtë:

“- Marrja e vendimit përfundimtar nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s për rastin e trajtuar në nenin 10 pika 2 paragrafi i fundit, do të kryhet me paraqitjen në ERE të marrëveshjes së koncesionit.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta